

Trajnimi për Auditimit e Performancës, Blloku 7 për audituesit e Vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë, Stokholm më 5-9 shtator, 2022

Në datat 5 – 9 shtator, 2022 në Zyrën Kombëtare të Auditimit të Suedisë, në Stokholm, u zhvillua moduli i fundit i trajnimit për auditimet e performances, i organizuar për audituesit e Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë.

Ky program trajnimi filloi në mars të vitit 2021 dhe përbëhej nga shtatë module, të cilat kishin si qëllim ndjekjen e procesit auditues në të gjitha fazat e tij, si dhe ndarjen e eksperiencës ndërmjet SAI-ve të angazhuar në këtë projekt.



Në kuadër të këtij projekti, audituesit e KLSH-së kanë gjeneruar Raportin e Auditimit të Performancës me temë “Garantimi i të Drejtave të Pasagjerëve në Transportin Ajror”, i cili u fokusua në performancën e Autoritetit të Aviacionit Civil, krah garantimit të të drejtave të pasagjerëve, duke shqyrtuar rregullimin ligjor të mbrojtjes së këtyre të drejtave dhe menaxhimin e situatës gjatë periudhës së pandemisë.

Audituesit e angazhuar në këtë program nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ishin Silvana Ramadani dhe Armols Zykollari, të cilët pas finalizimit me sukses të testimit të njohurive lidhur me metodologjitë e përdorura për analizimin e të dhënave në auditimet e performancës, janë çertifikuar.



Ceremonia zyrtare e çertifikimit u zhvillua në mjediset e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Suedisë, ku Audituesja e Përgjithshme, Helena Lindberg, zyrtarisht ka bërë shpërndarjen e çertifikatave për audituesit e angazhuar në këtë program trajnimi

Gjatë qëndrimit në Suedi, audituesit kanë vizituar gjithashtu edhe Parlamentin e këtij vendi, ku janë njohur me perspektivën parlamentare për auditimet e performancës.

